

**Njoftim për përqendrimin me të cilin HELLENiQ ENERGY Holdings S.A., Athinë,  
Greqi, do të fitojë kontroll mbi ELPEDISON B.V., Amsterdam, Holandë  
(lënda nr. 08-70/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24), më 26.03.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë

një njoftim për përqendrimin me të cilin HELLENiQ ENERGY Holdings S.A., me seli të regjistruar në adresën Himaras 8A, Marusi, Athinë, Greqi, synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi ELPEDISON B.V., me seli të regjistruar në adresën Naritaweg 165, 1043 BV Amsterdam, Holandë, dhe indirekt mbi ELPEDISON S.A., Frangoklisias 6, Marusi, Atiki, Greqi.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste**

**HELLENiQ ENERGY HOLDINGS S.A.** është një grup që operon në sektorët e rafinimit, furnizimit dhe tregtisë së karburanteve, energjisë së rinovueshme si dhe kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve.

HELLENiQ ENERGY HOLDINGS S.A. është aktive në disa sektorë, por kryesisht në sektorin e energjisë. Aktiviteti kryesor i grupit është rafinimi, i cili kryhet përmes shoqërisë së varur HELLENIK PETROLEUM S.A. (HELLENIC PETROLEUM S.A.).

HELLENiQ ENERGY HOLDINGS S.A. ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëria aksionare e rafinerisë së naftës OKTA - Shkup, me seli të regjistruar në rrugën 1 nr.25, Miladinovci, Ilinden, Maqedonia e Veriut (në tekstin e mëtejme: "OKTA SHA Shkup"). Regjistrimi i saj është për aktivitetin 46.71 – Tregtia me shumicë e karburanteve të ngurta, të lëngshme dhe të gazta dhe produkteve të ngjashme.

HELLENiQ ENERGY HOLDINGS S.A. gjithashtu ka një degë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

- Ndërmarrja për tubacionet e naftës Selanik-Shkup-VARDAKS SHA – Dega VARDAKS Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Miladinovci, Instalime/OKTA p.f.-66, Miladinovci, Ilinden, Maqedonia e Veriut (në tekstin e mëtejme: "VARDAKS Shkup"). Regjistrimi i saj është për aktivitetin 49.50 – Transport përmes tubacioneve.

**ELPEDISON B.V.** është një shoqëri holding

**ELPEDISON S.A.** është një shoqëri e themeluar në Greqi (në pronësi të plotë të ELPEDISON B.V.), e cila operon kryesisht në Greqi në sektorët e prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike dhe tregut me pakicë të energjisë elektrike, si dhe tregjeve të furnizimit me gaz natyror me shumicë dhe pakicë.

ELPEDISON S.A. ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëria tregtare dhe e shërbimeve ELPEDISON POWER GENERATION SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Shën Kirili dhe Metodi nr.48, Qendër, Shkup, Maqedonia e Veriut, (në tekstin e mëtejme: "ELPEDISON Shkup"). Regjistrimi i saj

është për aktivitetin 35.14 – Tregtia e energjisë elektrike. Megjithatë, ELPEDISON Shkup ende nuk është një subjekt afarist aktiv.

Përveç ELPEDISON Shkup, ELPEDISON B.V. nuk ka shoqëri të tjera të regjistruara apo degë në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu përkatës për këtë përqendrim mund të përcaktohet si tregu i derivateve të naftës dhe tregu i energjisë elektrike, të dyja në territorin e Republikës së **Maqedonisë së Veriut**.

*Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i diskutuar mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është rezervuar.*

*Komisioni i fton palët e interesuara të treta të paraqesin komentet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Komentet dhe mendimet e palëve të interesuara të treta mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose nëpërmjet e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të mbërrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.*

01.04.2025

Shkup